



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PEJË - DEGA E GJYKATËS DEÇAN

Numri i lëndës: 2022:018620

Datë: 26.12.2023

Numri i dokumentit: 05122291

C.nr.93/2022

GJYKATA THEMELORE NË PEJË, Dega në Deçan, Departamenti i Përgjithshëm, gjyqtari Bajram Cacaj, duke vendosur në çështjen kontestimore të paditësit M.K, nga Komuna e Deçanit, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson M.B, avokate në Deçan, kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, me seli në Deçan, të cilën e përfaqëson Dukagjin Povataj, Avokat Publik Komunal, me objekt kontesti kompensimi i shpërblimit jubilar, vlera e kontestit 494,52 euro, jashtë seance me datë 26.12.2023, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET si e pabazuar kërkesëpadia e paditësit M.K, përmes së cilës ka kërkuar që të: *“Obligohet e paditura që paditësit Sadri Haxhnikaj, në emër të shpërblimeve jubilarë të ia paguaj shumën prej 494,52 € apo 100 % të një pagës bazë për 37 vite të përvojës së punës, e të gjitha këto në afat brenda 7 ditëve nga dita e marrjes së aktgjykimit e deri me pagesën definitive, me kamatë ligjore prej 8 %, e cila fillon të rrjedhë prej ditës së paraqitjes së padisë deri në pagesën përfundimtare në kërcënimin e përmbarimit me detyrim, si dhe shpenzimet procedurale”*.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m

Paditësi, në këtë gjykatë me datë 31.01.2023, përmes të autorizuarës të tij, ka ushtruar padi kundër të paditurës Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit, për pagesën e shpërblimit jubilar, duke theksuar se paditësi është i punësuar si mësimdhënës pranë Sh.F.M.U. “Jusuf Gervalla” në Prapaqan, Komuna Deçan dhe duke u bazuar në Kontratën Kolektive të Arsimit në Kosovë, meqë e paditura nuk e ka përmbueshur detyrimin sipas kësaj Kontrate, kërkon që të përmbushët e njëjta në atë mënyrë që paditësit t’ia paguaj shpërblimin jubilar në lartësi prej 494,52 €, për 37 vite të përvojës së punës, ka kërkuar kamatën ligjore si dhe shpenzimet procedurale.

E paditura Komuna e Deçanit, përmes përfaqësuesit të saj, në këtë gjykatë ka parashtruar përgjigje në padi me datë 11.12.2023, ku ka theksuar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë si të pa bazuar për shkak të jashtë afatishmërisë – parashkrimit të kërkesëpadisë. Padiësi padinë e ka bërë jashtë afatit të paraparë me Ligjin e Punës, konkretisht nenit 87, ku të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës parashkruhen brenda 3 vitesh, kurse në rastin konkret padiësi ka paraqitur padinë në vitin 2022, pra padiësi nga momenti i nxjerrjes së kontratës kolektive të vitit 2017 në të cilën është thirrur ka pasur kohë të mjaftueshme për të kërkuar realizimin e kësaj të drejte, por nuk e ka bërë, andaj ka humbur të drejtën.

Gjykata pas shqyrtimit të padisë, provave që gjenden në shkresat e lëndës, si dhe përgjigjes në padi të paraqitur nga ana e të paditurës, në kuptim të nenit 8 lidhur me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), gjeti se janë plotësuar kushtet për dhënien e aktgjykimit jashtë seance dhe erdhi në përfundim se kërkesëpadia e padiësit është e pabazë dhe si e tillë u refuzua.

Nga parashtrimet e palëve ndërgjyqëse të paraqitura me padi dhe përgjigje në padi, gjykata ka gjetur se nga Kontrata e punës e lidhur në mes padiësit dhe të paditurës, në versionin e fotokopjuar, vërtetohet fakti se padiësi ka qenë në marrëdhënie pune tek e paditura në Sh.F.M.U. “Jusuf Gërvalla” në fshatin Prapaqan, Komuna e Deçanit, në cilësinë e mësimdhënësit, fakt i cili vërtetohet edhe nga vërtetimi me numër të protokollit 04-2561/20, i datës 02.11.2020, punëtor i të cilës shkollë është që nga data 01.09.1983, pra i njëjti ka 37 vite përvojë pune, fakti i cili vërtetohet edhe nga lista e pagave, për periudhën 01.07.2020 – 31.07.2020, nga e cila vërtetohet po ashtu se i njëjti pagën bazë e kishte 421 euro. Gjykata provave të lartcekura iu fali besimin e plotë ngase është bërë e besueshme fuqia provuese e tyre, duke u bazuar edhe në nenin 329 par. 1 të LPK, i cili përcakton se *“Shkresa të cilën e ka hartuar në formën e caktuar organi shtetëror brenda kufijve të kompetencës së vet, si dhe shkresa të cilën në formë të tillë e ka hartuar ndërmarrja apo organizata tjetër në ushtrimin e autorizimeve publike që i janë besuar me ligj (dokumenti publik), provon saktësinë e asaj që konfirmohet apo caktohet në të”*.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, pasi që pretendimet e të autorizuarës së të paditurës në lidhje me parashkrimin e kërkesës, i morri si të bazuara pasi që sipas provave të administruara vërtetohet se padiësi kërkesën e tij për kompensim në emër të shpërblimit jubilar e ka parashtruar pas afatit kohor prej 3 (tre) viteve siç parasheh neni 87 i Ligjit nr. 03/L-212 të Punës, i cili ka përcaktuar që *“Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para, parashkruhen brenda afatit prej tri (3) vitesh, nga dita e paraqitjes së kërkesës”*, ashtu që në rastin konkret gjykata ka vërtetuar se padiësi bazuar në vërtetimin e përvojës së punës të datës 02.11.2020, punëtor i shkollës në fjalë është që nga data 01.09.1983, pra më shumë se 37 vite, fakt i cili vërtetohet edhe nga lista e paga, andaj në bazë të përlllogaritjes i bie që 30 vitet e përvojës së punës i njëjti i ka mbushur në vitin 2013, ndërsa padinë e ka parashtruar me datë 31.01.2022 që nënkupton më shumë se tri vite nga lindja e të drejtës për kërkesën nga marrëdhënia e punës, përkatësisht lidhur me kompensimin e shpërblimit jubilar.

Për arsyet e cekura si më sipër, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi, duke pasur parasysh se në rastin konkret janë plotësuar kushtet ligjore për marrjen e aktgjykimit jashtë seancës të përcaktuara në nenin 399 të LPK, ku në paragrafin 1 të këtij neni është përcaktuar se *“Kur gjykata, pasi t’i arrijë përgjigja në padi, konstaton se nga faktet e treguara në padi nuk del themelësia e kërkesëpadisë, atëherë ajo do të jep vendimin meritore me të cilin refuzohet si e pathemeltë kërkesëpadia”*, ndërsa në paragrafin 2 është paraparë se *“Kërkesëpadia*

është e pathemeltë, në vështrim të paragrafit 1 të këtij neni, po që se qartazi është në kundërthënie me faktet e treguara në padi, apo, po që se faktet mbi të cilat mbështetët kërkesëpadia qartazi janë në kundërthënie me provat të cilat i ka propozuar paditësja, apo me faktet që janë botërisht të ditura”.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale si në pikën II të dispozitivit, u mor sipas nenit 450 të LPK.

Nga të lartcekurat, e bazuar në nenin 143, lidhur me nenin 399 të LPK, gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË PEJË

Dega në Deçan

Departamenti i Përgjithshëm

C.nr.93/22, datë 26.12.2023

Gj y q t a r i

Bajram Cacaj

KËSHILLË JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankese në afatin prej 7 ditëve, pas pranimit të tij, Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj gjykate.

Ankesa duhet të paraqitet në kopje të mjaftueshme për palët dhe gjykatën.